



Republika e Kosovës
Republican Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 41/15

Prishtinë, më 16.12.2015, ora 11:30

Ndertesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Ne mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Adem Grabovci, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta dhe Fikrim Damka.

Munguan: Safete Hadergjonaj, Jelena Bontić, Ilir Deda, Enver Hoti dhe Bali Muharremaj.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljeta Krasniqi, Dashurije Canolli, Medina Agushi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Kosovës për konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, lidhur me Vendimin e Qeverisë për ndryshimin e normës së tatimit të akcizës;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

- 2. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Kosovës për konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, lidhur me Vendimin e Qeverisë për ndryshimin e normës së tatimit të akcizës**

Kryetari - në baze të nenit 3 të Ligjit për tatimi të normës së akcizës në Kosovë, Qeveria me vendim mund të ndryshojë normën e akcizës për produktet në Aneksin A të këtij ligji, pas konsultimit me Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Avdullah Hoti - ky vendim është pjesë e marrëveshjes që kemi me FMN për harmonizim të politikave fiskale të Kosovës në vend dhe region tek akcizat. Vendimin që ka marrë Qeveria

është për rritje të akcizes në duhan, si për vitin e ardhshëm për 3 euro nga 38 euro sa është aktualisht në 41 euro si dhe për tri vitet tjera (2017-2019) të rritet nga 2 euro. Pavarësisht kësaj rritje ne ende qëndrojmë prapa vendeve të regjionit sa i perket akcizës në duhan, që normat e akcizës janë nga 37 euro në 46 euro. Përveç, kësaj është edhe direktiva e BE-së që i obligon vendet që aspirojnë të integrohen në BE të bëjnë përafrimet në të gjitha akcizat, duke filluar prej vitit 2014.

Bardhyl Metaj – si grup punues i komisionit, jemi në proces të mbikqyrjes së zbatimit të Ligjit për akcizës në duhan dhe do të adresojmë problemet nga puna që do të bëjmë dhe rekomandimet që do të nxjerrim për Kuvend, për shkak se Kosova ka një traditë të madhe për prodhimin e duhanit. Puna e mbikqyrjes do të vazhdojë në fillim të vitit të ardhshëm dhe do të tentojmë që ta sjellim gjendjen në nivel të regjionit. Do ta bëjme përshkallëzimin e akcizës. Është një punë që do ta bëjmë dhe që presim bashkpunimin dhe kordinimin me Ministrinë që drejtoni. Pra ne do votojmë këtë çështje mirëpo nuk do ta ndalojmë atë iniciativë që kemi.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxorri këtë

P ë r f u n d i m

I. Komisioni për Buxhet dhe Financa, përkrahu Propozim-Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.11/64, dt. 16.12.2015, për ndryshimin e normës së akcizës në duhan, si vijon:

1. Vendoset norma e tatimit të akcizës në duhan sipas këtij Kalendari:

1.1. Nga data 1 janar 2016, vendoset norma e tatimit të akcizës për kodin tarifar 240220 “cigaret që përmbajnë duhan” në shumën prej 41 €/njësi konvencionale;

1.2. Nga data 1 janar 2017, vendoset norma e tatimit të akcizës për kodin tarifar 240220 “cigaret që përmbajnë duhan” në shumën prej 43 €/njësi konvencionale;

1.3. Nga data 1 janar 2018, vendoset norma e tatimit të akcizës për kodin tarifar 240220 “cigaret që përmbajnë duhan” në shumën prej 45 €/njësi konvencionale; dhe

1.4. Nga data 1 janar 2019, vendoset norma e tatimit të akcizës për kodin tarifar 240220 “cigaret që përmbajnë duhan” në shumën prej 47 €/njësi konvencionale.

Mbledhja përfundoi në ora 12:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani